STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 22 nëntor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON FONDIN PREJ $1 MILIONE PER TE SIGURUAR SHERBIME LIGJORE FALAS PER PRONARET E SHTEPIVE DHE BIZNESEVE TE VOGLA NE LONG AJLEN (LONG ISLAND) TE PREKUR NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Fondi do të zgjerojë aftësinë e Klinikës së Rimëkëmbjes nga Katastrofa në Fakultetin e Drejtësisë Moris A. Din (Maurice A. Deane) në Universitetin Hofstra

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një fond prej $1 milionë për Klinikën e Rimëkëmbjes nga Katastrofa në Fakultetin e Drejtësisë Moris A. Din (Maurice A. Deane) në Universitetin Hofstra për të ndihmuar familjet dhe bizneset e vogla në Qarqet Naso (Nassau) dhe Safolk (Suffolk) të prekura nga super stuhia Sendi (Sandy). Fondi do të zgjerojë shërbimet falas të këshillimit në klinikë për 250 pronarë të shtëpive dhe biznese të tjera.

“Familjet dhe pronarët e bizneseve të vogla që tashmë kanë vuajtur mjaft nga dëmi i super stuhisë Sendi (Sandy) nuk duhet të pësojnë stres financiar shtesë të faturave ligjore të mëdha,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ky investim do t’u lejojë studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në Hofstra që të përdorin aftësitë e tyre për një përfitim të stërmadh publik, duke i shërbyer shtetit të tyre në ndihmën ndaj klientëve që kanë nevojë të kalojnë përmes gjendjeve të ndërlikuara -- dhe në dhënien e ndihmës që fqinjët e tyre të rindërtojnë jetën e tyre.”

Seth Daimënd (Seth Diamond), Drejtor i Rimëkëmbjës Shtetërore nga Stuhia, tha “Falënderoj Fakultetin e Drejtësisë në Hofstra dhe studentët e përkushtuar të tij në ngritjen në këmbë dhe në përkushtimin për të ndihmuar bashkëqytetarët e tyre në Long Ajlënd (Long Islanders) në rimëkëmbjen nga stuhia. Ky fond do të zgjerojë shërbimet falas të tyre për qindra familje dhe biznese të tjera në nevojë.”

Fondi u vendos në dispozicion nëpërmjet programit të Fondeve në Bllok për Rimëkëmbjen nga Katastrofa dhe Zhvillimin e Komunitetit (CDBG-DR) të Shtetit (State) të financuar nga Departamenti i Strehimit & Zhvillimit Urban i SH.B.A.-së. Fondi për Klinikën e Rimëkëmbjes nga Katastrofa të Fakultetit të Drejtësisë Hofstra do të lejojë që shërbimet të vazhdojnë deri të paktën maj 2015.

“Kjo është një mundësi e madhe për studentët tanë që të marrin trainim të drejpërdrejtë të aftësivë

ndërsa u shërbejnë anëtarëve të komunitetit tone që kanë mjaft nevojë për ndihmë ligjore," tha Dekani i Fakultetit të Drejtësisë në Hofstra Erik Lein (Eric Lane). "Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe personelin e përkushtuar në Ngritjen e NY për bërjen të mundur të këtij fondi. Gjithashtu falënderoj Presidentin Stjuar Rabinouits (Stuart Rabinowitz) për udhëheqjen e tij në reagimin e Fakultetit të Drejtësisë dhe të Universitetit ndaj shkatërrimit të Sendit (Sandy) menjëherë pasi goditi stuhia."

Nëpërmjet Klinikës së Rimëkëmbjes nga Katastrofa në Fakultetin e Drejtësisë Moris A. Din (Maurice A. Deane) në Universitetin Hofstra, të krijuar nga Profesori Majkëll Habër (Michael Haber), studentët e vitit të dytë dhe të tretë sigurojnë ndihmë ligjore të mbikqyrur falas për një sferë të gjërë çështjesh që prekin bizneset e vogla vendore dhe individët ndërsa rimëkëmben nga super stuhia Sendi (Sandy). Klinika trajton hetimin, diskutimin, apelet, ndërmjetësimet dhe gjyqet për çështjet që kanë një ndikim të madh në jetën e klientëve të saj. Që nga stuhia, klinika ka përfaqësuar rreth 75 familje dhe shumë biznese të vogla në Long Ajlënd (Long Island).

$1 milioni pritet të lejojë që Klinika e Rimëkëmbjes nga Katastrofa të zgjerohet nga një avokat dhe tetë studentë të drejtësisë në tre avokatë, 70 studentë të drejtësisë dhe 10 studentë J.D./M.B.A. dhe të sigurojë më shumë se 35,000 orë të ndihmës ligjore falas dhe 5,000 orë shtesë të këshillimit të biznesit për klientët në qarqet Naso (Nassau) dhe Safolk (Suffolk) gjatë dy viteve të ardhshme.

E vendosur në Fshatin Hempsted (Hempstead), Universiteti Hofstra është një institucion dinamik privat i arsimit të lartë ku më shumë se 11,000 studentë me kohë të plotë dhe të pjesshme zgjedhin nga lëndë të nivelit universitar dhe pas-universitar në arte dhe shkenca, biznes, inxhinieri, shkencë e zbatuar, komunikim, arsim, shkencat mjekësore dhe shërbimet njerëzore, studimet honorifike, Fakultetin e Drejtësisë Moris A. Din (Maurice A. Deane) dhe Shkollën e Mjekësisë Hofstra Bregu Verior-LIJ. Fakulteti i Drejtësisë në Hofstra ka pothuajse 850 studentë, një bazë të studentëve që kanë përfunduar prej më shumë se 10,600 anëtarë dhe një trup profesorësh prej më shumë se 50, përfshirë shumë studjues të njohur si ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e tyre.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418